



**PËR H. FEJZI ZAGANJORIN,
NË NJË DITË MIRËNJOHJE...**



**40 VITE
PA IMAM SALIH MYFTINË**



**PALESTINA, VENDI KU
BARAZOHET OKUPATORI ME ATË
QË E MBRON ATDHEUN E VET**

Viti 17 - Nr. 7 (197),
Korrik, 2019

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*

ME ZEMËR TË MIRË XHAMINË E RE NË LAGJEN DRAÇIN!

"Dita e sotme ka një simbolikë të veçantë për të gjithë komunitetin e muslimanëve të Shkodrës. Përrurimi i xhamisë së re në lagjen Draçin, është një gëzim i madh, i shumëfishtë. Pas më shumë se gjysëm shekulli, ezani do të dëgjohet sërish në këto nahi."





Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

“Po për ushqimin shpirtëror, a mendojnë njerëzit?”

A duhet ta lëmë shpirtin të vdesë?”¹

Ceremonia e ditës së sotme, ka një domethënie të veçantë për kohën: ditë e xhuma; për vendin: parlamenti i Shkodrës; dhe personin që na mblodhi në këtë event: i nderuari miku i krejtve, Haxhi Fejzi Zaganjori, veprimtari i zellshëm i Myftinisë Shkodër, njeriu i pajtimit, i paqes, i harmonisë, i vlerave qytetare, i mirësisë së besimit, por jo vetëm!

Në fakt, e kam pasur të vështirë të ulem e të rreshtoj këto fjalë, për disa arsye që lidhen me personin, për të cilin jemi tubuar së bashku në këtë sallë. Nuk është tamam e lehtë të flasësh për Haxhi Fejzi Zaganjorin dhe aktivitetin e tij të larmishëm.

Kemi të bëjmë me një veprimtar shoqëror shumë aktiv, në disa periudha të dekadave të fundit, sidomos nga viti 1990 e deri më sot.

Është pa dyshim njeriu i besuar dhe krahu i djathtë i Myftiut të Shkodrës Haxhi Faik Hoxha (1930-2011), aktivist për pajtimin kombëtar, pjesëmarrës në dhjetëra e qindra përpjekje për pajtimin e gjakut në zonat e veriut, por jo vetëm!

Është imam e vaiz, organizator i emisioneve fetare radiofonike në Radio “Shkodra”, pjesëmarrës në seminare e konferenca, simpoziume e përkujtimore të shumta lokale e kombëtare gjatë kësaj periudhe.

Po të shfletosh revistën “Drita Islame”, “Udha Islame”, por edhe përtej tyre, do të gesh thuajse për çdo numër të tyre një shkrim, një kronikë, një vështrim a analizë nga Ing. Fejzi Zaganjori, që me zell të madh dhe përkushtim të spikatur, u angazhua për të mësuar e studiuar njohuritë themelore të besimit dhe

PËR H. FEJZI ZAGANJORIN, NË NJË DITË MIRËNJOHJEJE...

fesë islame, për t’i ardhur në ndihmë Myftinisë Shkodër në momentet e saj më të vështira, sidomos pas rimëkëmbjes së dëshmuar të 16 nëntorit 1990.

Edhe në periudhën e myftilerëve të Shkodrës, Imam Ndrçim Sulejmani, Ermal Nurja dhe deri më sot, atë do ta gesh përherë si: imam, veprimtar të papërtueshëm, vaiz, kronikan, pajtimtar, zv/Myfti, sekretar i Këshillit të Myftinisë, por jo vetëm.

E gjithë kjo, dëshmon për dimensionet e personalitetit të tij dhe angazhimin e madh për të përhapur kudo vlerat qytetare, mirësinë e besimit, traditat e tabanit, frymën e harmonisë ndërjetare, atë të pajtimit kombëtar, si dhe përpjekjen e madhe për të thirrur drejt dashnisë së Zotit në jetë, tamam siç i drejtohet rinisë, me fjalët e tij: “Drejtohuni rrugës që urdhëron Allahu (xh.sh.) dhe Profeti Muhamed (a.s.), sepse aty është e vërteta, mirësia dhe çdo gjë e mirë.”²

Diku tjetër tërheq vëmendjen: “Njeriu, krahas të drejtave që ka, të cilat ia ka dhuruar Allahu (xh.sh.) ka edhe shumë detyrime që gjatë jetës duhet t’i plotësojë e t’i zbatojë. Pa dyshim më kryesori është besimi, adhurimi dhe lutjet që duhet t’i bëjmë Allahut të Madhëruar. Për të realizuar këtë duhet të mësojmë dhe të bëhemi të aftë që të kryejmë këtë detyrë...”³

Për vite të tëra, ai ka mbajtur mbi supë peshën e rëndë të përhapjes së fenomenit të vëllavrasjes, gjakmarrjes e përhapjes së anarshisë, njësoj sikurse sot, që e gjejmë më aktiv se asnjëherë, në thirrjet e tij, thuajse të përditshme; herë nga minberi e herë nëpërmjet rrjeteve sociale, thirrje që ftojnë për pendim e paqtim me Zotin, për përmirësimin e cilësisë së jetës në këtë vend të bekuar nga Zoti e të keqqueverisur nga rob!

Do të sjell në vëmendjen tuaj një paragraf nga një punim i tij në lidhje me aktivitetin e Myftinisë Shkodër për pajtimin kombëtar dhe faljen e gjakut. Shkruan: “Një ndër të drejtat më themelore të njeriut, që ia ka dhuruar Allahu (xh.sh.) është e drejta mbi jetën. Por, në këto kohë të fundit në përmasa të

vogla apo të mëdha po përjetojmë ngjarje tragjike, ku vetëvrasjet, hakmarrjet dhe vrasjet po marrin jetën e të rinjve tanë.”⁴

Dhe, kontributin e tij të spikatur në këtë frymë, ai e ka dhënë në vitet e vështira të përhapjes së anarshisë dhe vëllavrasjes ndër shqiptarë, ku së bashku me drejtuesit e nderuar të komuniteteve fetare, drejtues të qytetit, intelektualë, qytetarë e besimtarë, nuk ndaloj një herë së punuari për pajtimin e paqen, për vëllazërinë kombëtare e harmoninë komunitare.

Nuk dyshim se, aktiviteti i zotnisë së tij, nga momenti i parë i angazhimit në Myftininë Shkodër e deri më sot, mund të përmbledhet në pak fjalë, që ai vetë i ka shkruar para shumë vitesh, kur thotë: “Ne duke njohur dhe adhuruar Allahun (xh.sh.), do të kemi mundësi që të vishemi me atributet e Tij sublimë, si mëshirues, i dashur, bamirës, falës, etj. dhe njëherit jeta do të funksiononte në paqë e pa të këqia. Lumturia do të arrihet nëpërmjet ushtrimit të ligjeve morale dhe të drejtave që ka çdo individ. Dëshira për të pushtuar kështjellën e lumturisë nëpërmjet kënaqësive materiale, duke u zhveshur nga bota e brendshme, do të përfundonte në një zhgënjim të plotë. Qëllimi i jetës së njeriut duhet të jetë dhe është të çelurit e dritës së zemrës ndaj Allahut (xh.s.).”⁵

Të dashur të pranishëm,

Në emër të Myftinisë Shkodër, falënderoj për zemërsisht Këshillin e Bashkisë Shkodër, Kryetarin e nderuar, antarët dhe krejt ata që u angazhuan për realizimin e këtij nderimi për imamin e e xhamisë Rus, të nderuarin H. Fejzi Zaganjori, të cilin e falënderoj për shembullin e tij, për përkushtimin dhe punën e madhe, si dhe kontributin përherë në rritje për të mirën e qytetit dhe komunitetit tonë.

I dashur Haxhi Fejzi,

Shëndet të plotë, pleqëri të mbarë, mirënjohje dhe respekt!

Shkodër, më 19 korrik 2019

2. Haxhi Fejzi Zaganjori, gazeta “Udha Islame”, viti i pestë i botimit, nr. 52, janar, 2007, f. 9.
3. Haxhi Fejzi Zaganjori, gazeta “Udha Islame”, viti i parë i botimit, nr. 5, shkurt, 2003, f. 7.
4. Haxhi Fejzi Zaganjori, gazeta “Udha Islame”, viti i pestë i botimit, nr. 53, shkurt, 2007, f. 4.
5. Haxhi Fejzi Zaganjori, gazeta “Udha Islame”, viti i tretë i botimit, nr. 28, janar, 2005, f. 10.

ME ZEMËR TË MIRË XHAMINË E RE NË LAGJEN DRAÇIN!

Të dashur të pranishëm, motra dhe vëllezër,

Dita e sotme ka një simbolikë të veçantë për të gjithë komunitetin e muslimanëve të Shkodrës. Përrurimi i xhamisë së re në lagjen Draçin, është një gëzim i madh, i shumëfishtë. Pas më shumë se gjysëm shekulli, ezani do të dëgjohet sërish në këto nahi.

Xhamia do të vazhdojë të mbajë dyert e hapura për besimtarët; banorët e lagjes, kalimtarët, vizitorët dhe këdo që e ndjen se, jeta pa dritën e besimit është një rrugëtim i gjatë në labirinte pa dritë, ku busulla tekanjoze nuk udhëzon, ku ekuilibri lëkundet, ku nga e djathta dhe nga e majta (edhe pse duken se janë në opozitë me njëra-tjetrën, njëkohë që pa njëra-tjetrën nuk bëjnë dot), na vijnë goditje të panumërta, herë të mbështjella me zjarr e herë me mëndafsh; ku të gjithë pa përjashtim, do të gjejnë një cak, që busullës i jep dritë, ekuilibrit qëndrueshmëri, të djathtës dhe të majtës ujin e pastrimit, shpirtit e zemrës ushqimin e mjaftueshëm e të duhur për rrugëtimet e jetës!

Të dashur të pranishëm,

Mbrëmë vonë, së bashku me Arjanin, teksa po i hidhnim një sy objektit të ndriçuar, më erdhën ndër mend peripecitë e prag-fillimit të punës për ndërtimin e kësaj xhamie të re në këtë lagje të vjetër.

M’u kujtua gatishmëria plot përkushtim e z. Ruzhdi Pecës, komshiut tonë, që jeton mbi vakëfin e vjetër, të cilit iu bë roje besnik e mbrojtës i heshtur; por që, prej kësaj dite, do ta përmendim përherë me respekt dhe do të gëzojë mirënjohjen tonë për aktin e tij fisnik, pa të cilin, sot nuk do ta kishim xhaminë e re, ose do të na shihnit duke u orvatur korridoreve të gjykatave, ku në këto 29 vite, më shumë kemi humbur se kemi fituar të drejtat legjitime të vakëfeve të zaptuara e të grabitura në xhunglën ku jetojmë!

Si një shirit i shpejtë, që të kujton momente që nuk duhen harruar, u shfaqën para syve të mi, profile me korniza drite e vlerash, pa të cilët nuk do të gëzonim këtë ditë dhe simbolikën e saj.

I falënderova me zemër, një e nga një, duke nisur me vëllanë e dashur dhe punëtorin e zellshëm për rimëkëmbjen e infrastrukturës së besimit dhe Thirrjes



Sot, xhamia më e re në Shkodër hap dyert e saj. Pas pak, ezani i parë do të mbushë me emocion dhe do të ngrohë zemrat. Dalëngadalë, të rinjtë e lagjes, që gjatë këtyre ditëve i kam parë shumë të interesuar për xhaminë, gati-gati të paduruar për këtë ditë të begatë; do të kenë tashmë një prag të madh që i mban të lidhur me zemrën e Resulull-llahut (a.s.), me dritën e Kur’anit, me udhëzimin e fesë dhe urtësinë e shekujve...

Islame në Shqipëri, të nderuarin z. Korab Kaja dhe krejt vëllezërit e Kryesisë së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Myftinisë Shkodër, Fondacionit “Mirësia”, firmës ndërtuese, Bashkisë Shkodër, Policisë Shkodër dhe krejt ata banorë të nderuar të lagjes Draçin, që kontribuuan nga brenda dhe nga jashtë vendit për xhaminë e re, me lutjen që All-llahu i Madhëruar t’ia begatojë jetën me mirësitë dhe bekimet e Tij!

Falënderova në heshtje mirësinë e madhe të donatorëve dhe vëllezërve të shtrenjtë nga Kuvajti i bamirësisë, Kuvajti i Emirit të Humanizmit, Kuvajti i projekteve të dëshmuara bamirëse, humanitare, kulturore, shëndetësore, por jo vetëm, që anëmbanë botës, dhurojnë mirësi e paqe, nëpërmjet realizimit të tyre!

Vëllezër të dashur,

Sot, xhamia më e re në Shkodër hap dyert e saj. Pas pak, ezani i parë do të mbushë me emocion dhe do të ngrohë zemrat. Dalëngadalë, të rinjtë e lagjes, që gjatë këtyre ditëve i kam parë shumë të interesuar për xhaminë, gati-gati të paduruar për këtë ditë të begatë; do të kenë tashmë një prag të madh që i

mban të lidhur me zemrën e Resulull-llahut (a.s.), me dritën e Kur’anit, me udhëzimin e fesë dhe urtësinë e shekujve, që na lidhin të gjithëve së bashku me madhështinë e ajetit kur’anor: “Në të vërtetë, All-llahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju t’ia vini veshin.”¹

Me zemër të mirë e mbarësi xhaminë e re të lagjes Draçin!

All-llahumme zbrit mëshirën Tënde mbi banorët e kësaj lagjeje; udhëzo të devijuarin, kthe të larguarin, përmirëso të hutuarin, mbulo me dritën dhe bekimet e Thirrjes Tënde zemrat tona dhe na dhuro kurajo e forcë për të jetuar me dinjitetin e besimit dhe krenarinë e Islamit! Amin!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

(Fjala e mbajtur me rastin e përrurimit të xhamisë së re në lagjen Draçin)

Shkodër, më 19 korrik 2019

1. Kur’ani, En-Nahl: 90.

40 VITE PA IMAM SALIH MYFTINË, THEMELUES I QENDRËS ISLAME SHQIPTARO – AMERIKANE PËR SHTETET NEW YORK DHE NEW JERSEY

Nga: **Leonora Laçi**

Imam Salih Myftia (1891-1978) lindi në shekullin e trazirave e përpjekjeve për autonomi, në vitin e largët 1891, bashkëkohës i ngjarjeve më rëndësi kombëtare, siç ishte Pavarësia e Shqipërisë, që u skalit me shkronja të arta në historinë tonë, apo dhe ngjarjeve të dhimbshme për mbarë botën e qytetëruar, siç ishin dy Luftat Botërore.

Ka rrjedhur nga një familje shkodrane, që ka qenë dhe është përherë kontribuese në çështjet me karakter fetar apo kombëtar dhe ka nxjerrë liderë të hershëm të komunitetit mysliman aty. Madje, në fillim të viteve 40, njëra nga bibliotekat më të mëdha të Shkodrës ishte biblioteka e familjes Myftia.

Salihi, mësimet e para, do i merrte në një shkollë turke në Shkodër, në vitet 1898-1904, por krahas mësimave fetare, do ketë zell dhe për çështjen kombëtare, që po kristalizohej në fillim të shek.XX. Që në moshë të re, do të jetë partizan që në shkollat shqipe të mesohej me germa latine. Ishte njohës i gjuhës turke të vjetër e arabishtes.

Asnjëherë nuk do i humbi shpresat që atdheun ta shihte të përparuar e të zhvilluar. Kjo shihet në nismën për pavarësimin e xhamisë shqiptare nga ajo turke, e për këtë, do mbahet Kongresi I Mysliman, në 24 shkurt 1923, në Tiranë. Po ashtu, do jetë inisiator për përkthimin e Kur'anit në shqip, për ta bërë lehtësisht të kuptueshëm për shqiptarët myslimanë. Salih Myftija, përveç mesimeve fetare, do nxishte dhe dashurinë për atdheun.

Në vitin 1927 do caktohet Myfti në Krujë, e më vonë, Kryemyfti i prefekturës së Shkodrës e Kosovës, me vendim të posaçëm të Këshillit të Naltë të Sheriatit. Shërbimin e tij si kryemyfti, do ta bëjë më së miri, kultura e diapazoni i tij i gjerë do të reflektohej tek besimtarët, ku armë më të mirë kishte: “Tolerancën, besimin në Zot (Allah) e flamur”.

Imam Salih Myftija asnjëherë nuk u pajtua me pushtuesin fashist. Për këtë, ai u internua në Gjirokastër, për afro dy vite dhe u shkarkua nga detyra e Kryemyftiut me dekret të Viktor Emanuelit III.

CILI ISHTE QËNDRIMI I IMAMIT KARSHI PUSHTUESIT E KOMUNISTËVE?!

Pas kapitullimit të Italisë, në shtator të 1943, do të vihet sërish në radhët e nacionalistëve e kryesisht si simpatizues i grupit të Legalitetit, por sërish si i pa kompromis. Këtë e thotë i biri Dr. Fuad Myftija, në kujtimet e tij: “Babai ishte figurë në lëvizjen Kombëtare, ka qenë ndër të parët nacionalistë e asnjëherë nuk ka bërë kompromis, as me fashistët e as me nazistët. Ngritëm grupe ilegale dhe çetat kundër gjermanëve...”



Ajo që vihet re në këtë kohë delikate për Shqipërinë, është se tashmë, armiku i nacionalistëve nuk ishte vetëm i jashtëm (gjermanët), por dhe i brendshëm (komunistët). Me gjithë përçarjet mes klerit katolik e atij mysliman, pra ndikonte rreziku i përbashkët që i kërcenohej nga LNÇL, e harruan këtë grindje dhe u bënë miq e bashkëpunëtorë të ngushtë. Bashkëpunimi do të vijë pas zhvillimeve të Mbledhjes së Mukjes, ku personalitete si: Salih Myftija, Hafiz Ali Kraja, Mons.Thaçi, P.Anton Harapi, Sulço Begu, etj, vendosën që të krijojnë frontin antikomunist. U krijuan varg disa besëlidhje krahinore, si në Shkodër, Pukë, Lezhë etj, të cilat kërkuar me ngulm zbarkimin e anglo-amerikanëve...

Shtëpia e imam Salih Myftisë ishte bërë pikëtakim për nacionalistët ku u takuan, u pritën e përcollën ngrohtësisht nga i zoti i shtëpisë, me urtinë që e karakterizonte. Dr. Fuadi vazhdon: “Në këtë kohë kishte ardhur Mid’hat Frashëri me Baba Rexhepin e me Zef Palin. Të gjithë krerët ishin mbledhur në

Shkodër.” Imam Salih Myftia, së bashku me atdhetarët e tjerë, si: Fuad Myftia, kolonel Xhemal Laçi, Teki Xhindi, Hysen Prishtina e dhjetra të tjerë, u larguan nga vendi drejt Tivarit. Pikërisht me 21 nantor 1944 (Gazeta “Atdheu” mars-prill 1988), por pas pengesave, që i solli policia malazeze, për faktin se ishin të armatosur, ata u detyruan të lundrojnë me një barkë të vjetër në drejtim të Detit Adriatik, duke mbërritur në qytetin bregdetar të Brindizit të Italisë. Ata më pas u dorëzuan në komandën ushtarake të aleatëve, të cilët më vonë i vendosën në kampet e Italisë.

ARRATISJA NË KAMPET E GRUMOS ME ROBËRIT E LUFTËS

Siç shpreh Dr. Fuadi, ky vend ishte i skuqur gjithandej me flamujt rus e yll të kuq, drapër e çekanë. Kampet ishin në gjendje të mjeruar. Shqiptarët ishin të palarë, pis, sepse vinin nga malet. Rregullat e disiplina ishin të rrepta. Përveçse trajtoheshin keq, edhe hetoheshin. Imami Salih Myftia shquhej për urtinë e tij, madje shpesh herë, shuante konfliktet mes zogistëve e ballistëve. Kushtet e këqija të kampit nuk e mposhtën dhe as e përkulën gjakëftohtësinë e largpamësinë e këtij njeriu paqedashës, ku me besimin në Zot, ja dilte mbanë të kontrollonte qetësisht shumë situata, kur shqiptarët e tjerë e kishin humbur durimin. Salih Myftija ia ushqeui dashurinë për arsimin të birrit që ishte njëherësh mik e bashkëudhëtar në rrugët e vështira të emigrimit të padëshiruar, pasi qëndrimi në Shqipëri nuk ishte i mundur në një situatë të tillë të disfavorshme për nacionalistët, Fuadi u arsimua dhe u diplomua në Itali.

Konsideratë për Salihin kishte, përveç Mbretit Zog, që e bëri dhe këshilltar të tij, ai u zgjodh në krye të komisionit, që udhëtoi drejt Egjiptit për një takim me Mbretin e mërguar, ku u mblodhën të gjitha grupet politike. Konsideratë për të, patën dhe anglo-amerikanët, pasi miqësinë imami nuk e ndërtonte mbi pikëpamje politike apo bindje fetare, prandaj justifikohet pse ata e mbajtën afër.

Para ca vitesh, është botuar një dokument që mban vitin 1945. Ai thotë: “Në Janar të vitit 1945, dy politikanë shqiptarë, ndonëse të internuar në një

kamp tranzit në Bari, i mirënjohuni Mit’hat Frashëri, që ishte kreu i Ballit Kombëtar dhe një klerik nga Shkodra, Salih Myftija, ky i dyti në emër të organizatës “Legaliteti”, i kanë kërkuar Sekretarit Amerikan të Shtetit në detyrë, të mos ndërmerrej asnjë nismë për njohjen e qeverisë komuniste të krijuar para çlirimit të vendit. (Ky dokument është publikuar nga anglezët në një uebsite” Investigim” viti 2000).

Nga Egjipti, imami udhëtoi në Siri e Liban, e së fundmi, u vendos në ShBA në vitin 1965, ku si vend i parimeve të lirisë së shprehjes e besimit fetar dhe vend i demokracisë, ai vazhdoi pa problem aktivitetin e tij kombëtar e fetar.

KALVARI I FAMILJES SË SALIH MYFTISË

Si shumë familje të tjera nacionaliste, dhe familja Myftija provoi internime dhe burgosje. Për këtë, na vjen në ndihmë vepra enciklopedike “Kalvari i grave në burgjet e komunizmit” e studiueses Fatbardha (Mulleti) Saraçi, për bashkëshorten e imam Salih Myftisë shkruan:

“Qamile Myftija (1903-1974), edhe për të jeta erdhi plot peripeci, mbas vitit 1944. I shoqi, Salih Myftija, i nderuem në rrethin e besimtarëve myslimanë e në popullin e Shkodrës (ishte eksponent i organizatës së Legalitetit), mbasi kishte provue internimin e fashistëve italianë, që detyrue të arratisesh në fundin e nandorit të zi të atij viti, tue lanë gruen e shtatë fëmijët (nga 3-13 vjeç përveç Fuadit që e mori me vehte). Si fillim ajo pësoi paraburgimin 5-javor. Mandej shpronësimi e të tjera... Pas katër vjetësh, djali i saj 17 vjeçar, nga bankat e gjimnazit u përplas qelive të Sigurimit, për të provue torturat e tij e ma vonë edhe pesë vite burg. Ishte ende heret... Viti 1962 do t'i jepte një goditje edhe ma të randë. Djali tjetër, Mithati, që ishte nga natyra shumë i ndijshëm, tue mos durue persekutimin, kalon në krizë nervore. Një djalë në burg, një tjetër në spitalin psikiatrik, burri në arrati. Për çfarë të mendojë ma parë? Prapë, kishte edhe ma zi... Atë vit, ajo dhe dy djemtë e mbetun internohen. Ishte 60 vjeçe e do t'i duhej të nxirrte bukën e gojës, tue ba punë të ndryshme bujqësore. Si, shumë shoqe të saja... Me mendimin se një ditë do të kthehej në shtëpi, me mendimin se i biri do të shërohej. Vetëm ai të shërohej, ani pse në barakë mungonte pothuaj çdo gjë, ani pse nuk kishte forca për të përballue punën e randë. Nuk i shkonte mendja, se djalin, pasi do t'ia ndërpritnin kurën, do t'ia përplasnin baltave të Myzeqesë, aty

ku ishte edhe vetë. A mund ta duronte zemra e saj e lodhun këtë gjendje? I duhej. Djali kishte nevojë ma shumë se kurgja për fjalën e saj të ngrohtë, që vetëm nga thellësia e shpirtit të saj mund të delte. Ajo i dha qetësinë, ngrohtësinë, butësinë. I dha edhe besimin për një ditë ma të mirë, i hapi horizontin, i tha të shikonte përtej, në kaltërsinë që do të vinte. Nuk do të ishte ma mirë gjendja ekonomike edhe kur do të ktheheshin nga internimi. Të gjithë në punë krahu, të gjithë në punë të randa. Ndonëse të kulturume, sepse ata nuk e kishin heqë librin nga dora, nuk mund të gjenin punë ma të mirë. E nana e vuante edhe këtë. Vuenin sidomos persekutimin e njerëzve të veshun me pushtet. Sa herë u vinte rasti. Vuente sidomos Mithati. Atë e vriste edhe keqardhja e dashmirëve, deri një ditë, që me vetëdije mbylli jetën e vet nën rrotat e një kamioni. Historia njihnte këso rastesh, por përgjithësisht nuk ishte marrë me botën shpirtërore të nanave që duhej të përballonin dhimbjen që vinte mbrapa. Pas pak vdiq edhe vetë. “Nuk vdiq. Ajo plasi” - do të thoshte e bija. Dhe kishte të drejtë” - kështu mbyllet rrefimi për Qamile Myftinë dhe kalvarin e saj përgjatë regjimit gjakatar komunist që nuk kurseu as fëmijët, as grate.”

KRIJIMI I QENDRËS ISLAMIKE SHQIPTARO-AMERIKANE, SI VATËR E NGROHTË E SHQIPTARËVE

Teologu, atdhetari, intelektual i ku Atdheun asnjëherë nuk e harroi, por u mundua t'i shërbejë dhe pse nga larg, imami Salih Myftija kontribui në ngritjen e qendrës fetare, atdhetare, shoqërore, arsimore, edukative e kulturore. Meritë për këtë, ka dhe imami Isa Hoxha (1918-2001). Nevoja për një Qendër, që të shërbejë si vendtakim mes shqiptarëve, u rrit me rritjen e numrit të shqiptarëve myslimanë në ShBA. Mbledhja e 16 majit 1966, nën udhëheqjen e Salih Efendi Myftisë të kësaj qendre Islamiqe Shqiptaro-Amerikane, arriti në përfundim që të themelohet një Xhami, që të shërbente për forcimin e moralit, si dhe të përhapjes së mesimeve fetare e dashurisë për atdheun mes besimtarëve.

Në 12 nëntor 1972, Salih Myftija, pas shumë përpjekjeve e punës së palodhur e përkushtuese, preu shiritin e Xhamisë në Brooklyn të NY, ku u përshëndet nga mjaft personalitete si dhe shtypi vendas amerikan e shtypi shqiptar i Amerikës.

Vlen të përmendet dhe miqësia e ngushtë me monsinjor Zef Oroshin (1912-1989) udhëheqësin e themeluesin e Kishës së Parë Katolike Shqiptare në ShBA.

Imami u nda nga jeta në 19 maj 1978, në moshën 87 vjeçare. Në ceremoninë mortore, morën pjesë përfaqësues nga tre besimet fetare. Një figurë e shquar si Salih Myftija, e meritonte që lamtumira e fundit t'i jepej në mënyrë të denjë, ashtu siç ishte dhe veprimtaria e tij e admirueshme në rrafshin kombëtar e fetar.

Në një artikull të revistës së përkohshme fetare dhe kulturore “Përpjekja e Jonë” vol. X, mars-prill 1981, nr 9-10, (fq 121) i kushton një nekrologji Imam Salih Myftis, ku shkruhet mes të tjerash: “Salih Efendija ishte jo vetëm udhëheqës shpirtnuer, por edhe një Atdhetar i merituem e i respektue nga e gjithë mergata politike shqiptare. Fesë e Atdheut i ka sherbye me zotsi e dinjitet dhe me një guxim të pasqor. Ardha e tij në Shtetet e Bashkueme t’Amerikes i ka ndihmue komunitetit t’onë shqiptar mysliman aq sa me njiherë u vunë themelet e Xhamisë dhe të Qendres s’onë Islame. Kjo gja u ba e mundun vetem me praninë e personalitetit dhe të autoritetit të Salih Myftisë(...)”

Në maj të 2012, ish-Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi vlerësoi me “Medalje Mirënjohjeje” Sali Efendi Myftinë (pas vdekjes), me motivacion: “Për kontributin e dhënë në krijimin e institucioneve fetare të emigrantëve shqiptarë në ShBA, në mbështetjen e tolerancës fetare dhe të bashkëpunimit në dobi të interesave kombëtare.”

Imam Salih Myftija mbetet një nga personalitetet më të rëndësishme të emigracionit shqiptar dhe përbashkues i shqiptarëve të besimeve të ndryshme fetare.

(www.panorama.com.al)

Burimet e këtij artikulli:

- Xhemal Laçi përmes dokumentave dhe kujtimeve” Leonora Laçi, 2M Printing, Durrës: 2016.
- “Përpjekja e Jonë” Revista e përkohshme fetare dhe kulturore, vol. X, mars-prill 1981, nr 9-10.
- “Kalvari i grave në burgjet e komunizmit” Fatbardha (Mulleti) Saraçi, Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasovaje të Komunizmit (ISKK), Tiranë:2013.
- Leonora Laçi, Imam Salih Myftija, Gazeta Telegraf, Mars 2014. <http://telegraf.al/opinion/leonora-laci-imam-salih-myftija-veprimtar-i-shquar-per-fe-e-atdhe-1891-1978>.
- Shkëputur nga intervista, marrë nga Dalip Greca Dr.Fuad Myftisë, shkurt 20,2007.
- Shkëputur nga kumtesa e Nexhmi Bushatit, mbajtur në sesionin shkencor të X të Shoqatës Trojet e Arbërit.

Republika e Irakut është një shtet arab, që gjendet në pjesën perëndimore të Azisë. Ky vend kufizohet me Turqinë në veri, me Iranin në lindje, me Kuvajtin në juglindje, me Arabinë Saudite në jug dhe jugperëndim, me Jordaninë në perëndim dhe me Sirinë në veriperëndim. Iraku zotëron një vijë shumë të vogël bregdetare, prej vetëm 58 kilometrash, përgjatë Gjirit Persik.

IRAKU

Iraku ka një sipërfaqe prej 434.924 km², dhe një popullsi prej 40.194.216 (sipas të dhënave të vitit 2018).

Gjuha arabe dhe gjuha kurde janë gjuhët zyrtare të Irakut. Në vend fliten edhe disa gjuhë të tjera, në zonat të ndryshme të Irakut, si gjuha asiriane, turkmene dhe ajo armene.

Islami është feja zyrtare në Irak, dhe është e përhapur në masën 99% të popullsisë, që e përbëjnë komunitetet sunite dhe shiite. Në vend është i pranishëm edhe krishtërimi, i cili është i përhapur mes komuniteteve të tjera të popullsisë.

Përsa i përket ekonomisë së vendit, atë e dominon sektori i naftës, duke përbërë 95% të të ardhurave kombëtare të Irakut.

Klima e vendit është kryesisht shkretëtore, me dimër të butë dhe me verë të thatë, të nxehtë dhe pa re. Rajonet malore veriore të vendit, përgjatë kufijve me Iranin dhe Turqinë, karakterizohen nga dimri i ftohtë, me rreshje të herë pas hershme të mëdha të borës, që shkrihen në pranverën e hershme, duke shkaktuar ndonjëherë përmytje të mëdha, në pjesën qendrore dhe jugore të Irakut.^[1]

Bagdadi është kryeqyteti i Irakut, dhe qyteti më i madh në vend; qytete të tjera të mëdha në Irak janë: Basra, Naxhaf, Kufa, Kirkuk, Mosul, Ninevi, Erbil, etj. Nëpër Irak kalojnë dy lumenj të begatë, lumi Eufrat (ar. Furat) dhe lumi Tigër (ar. Dexhle).

Në hadithet e sakta të Buhariut, transmetohet nga Enes ibn Malik se i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “(Natën e Israsë dhe të Miraxhit) M’u zbulua Sidra (një pemë në qiellin e shtatë), dhe m’u treguan katër lumenj: dy lumenj të dukshëm dhe dy lumenj të fshehur. Përsa u përket dy lumenjve të dukshëm, ata janë lumi i Nilit dhe Eufrati, ndërsa dy të fshehurit, janë dy lumenj në xhenet.”

NJË VËSHTRIM I SHKURTËR I HISTORISË SË LASHTË TË IRAKUT

Gjatë kohërave parahistorike, zona

REPUBLIKA E IRAKUT

duke filluar nga vendburimi i lumejve Tigër dhe Eufrat, dhe që përbën pjesën më të madhe të Irakut, njihej me emrin “Vendet mes dy lumejve”, emërtim i cili erdhi nga greqishtja “Mesopotamia”, që do të thotë “Toka mes dy lumejve”. Kjo zonë përfshinte përfshinte Irakun, Kuvajtin, Sirinë, dhe në një masë më të vogël Turqinë dhe Iranin.

Ndërsa emri “Irak” me të cilin njihet sot ky vend, daton që nga shekulli i gjashtë i erës sonë, dhe besohet se origjina e këtij emërtimi vjen nga arabizimi i qytetit Sumerian “Uruk”. Studiues të tjerë besojnë se emri “Irak” rrjedh nga gjuha persiane, që do të thotë “ultësirë-tokë e ulët”.



Dy lumenjtë e bekuar, Tigër dhe Eufrat, kalojnë nëpër Irak, dhe takohen në kompleksin e njohur si Shatt al-Arab, përpara se ujërat e tyre të derdhen në Gjirin Persik.

“MESOPOTAMIA”- “VENDET MES DY LUMEJVE”

Zona e Mesopotamisë është dëshmitare e shumë qytetërimeve të lashta. Sipas informacioneve që kanë historianët, qytetërimi më i vjetër atje daton më herët se 3700 (p.e.s), dhe bëhet fjalë për qytetërimin arabo-sumerian.

Popullsia e zonës së Irakut, e ka origjinën nga fiset arabe, të cilët u larguan nga Gadishulli Arabik, për në

Mesopotami, në mijëvjeçarin e gjashtë (p.e.s). Në atë kohë, shumëfise arabe u shpërngulën nga Gadishulli Arabik, për t’u vendosur në viset e Gjysmëhënës Pjellore, në përgjithësi, dhe në rajonin e Eufratit, në veçanti.

Sumerianët kontribuan në ndërtimin e këtij qytetërimi nëpërmjet shkrimit kuneiform. Sumerianët konsiderohen si populli i parë që njohën shkrimin. Ndërsa arabët, me përvojën e tyre, vepronin në fushën e inxhinierisë së ujitjes, nëbujqësi, në prodhimin emjetevetë ndryshme, dhe në tregtinë e brendshme dhe të jashtme. Asokohe u themeluan një numër qytetesh, të tillë si qyteti Uruk, në fund të mijëvjeçarit të katërt.

QYTETI URUK, I LASHTË

Në vitin 2350 (p.e.s), akadianët arabë, i pushtuan vendet sumeriane, dhe sundimi i tyre zgjati deri në vitin 2200 (p.e.s). Pastaj, akadianët u mposhtën nga Gutët dhe nga fiset e tjera të ardhura nga malet.

Më vonë, sumerianët dhe akadianët bashkuan dhe krijuan një mbretëri të re të përbashkët, e cila më vonë u rrëzua nga Elamitët e Iranit, në vitin 2003 (p.e.s).

Që pas rënies së shtetit sumerian-akadian, arabët amoritë vazhduan të emigronin për në Mesopotami, duke krijuar atje shumë mini-shtete, të tilla si shtetet e Asirisë, Esenit, Larsës, si dhe

shtetin e Babilonisë që e morën. Më pas, amoritët arritën ta merrnin nën kontroll gjithë zonën “midis dy lumenjve”. Ata vazhduan të mbretërojnë në atë zonë, që nga viti 1894-1594 (p.e.s). Nga mbretërit më të famshëm të amoritëve ishte Hamurabi, autori i Kodit të famshëm të Hamurabit.

Më vonë, në vitin 1594 (p.e.s), Amoritët u mposhtën nga Kashinët, të cilët mretëruan deri në vitin 1153 (p.e.s).

Kashinët pastaj u rrëzuan nga Asirianët, të cilët mbretëruan deri në vitin 612 (p.e.s).

Asirianët e kishin origjinën nga fiset arabe, që kishin ardhur dhe ishin vendosur në zonën e lumit Tigër, që në mijëvjeçarin e katërt (p.e.s).

Në vitin 612 (p.e.s), Shteti Asirian u rrëzua nga Babilonasit, nën drejtimin e Nabopolasar-it, duke krijuar Shtetin e Babilonisë së Dytë.

Më vonë, Nabopolasarin e trashëgoi i biri, Bahtensiri, i cili sundoi nga 605 deri në vitin 562 (p.e.s). Me vdekjen e Bahtensirit, vendin e trashëguan mbretër të dobët, derisa Kiri persian e rrëzoi Shtetin e Babilonisë së Dytë, në vitin 539 (p.e.s).

Mbreti Kiri e bëri qytetin e Babilonisë kryeqytet të mbretërisë së tij. Persianët vazhduan të mbretërojnë në Irak, derisa u mundën nga Aleksandri i Madh i Maqedonisë, në vitin 321 (p.e.s).

Nën sundimin e Familjes Seleukide maqedonase, zona dëshmoi shumë luftëra, të cilat përfunduan me rënien e shtetit Seleukid, nga Partët (në vitin 141 p.e.s) që vinin nga Irani. Sundimi i partëve vazhdoi deri në vitin 224 (e.j), kur u mposhtën nga sasanidët persianë. Këta të fundit, vunë në krye të këtyre zonave një mbret arab, nga fisi arab Tenukh, dhe më pas, në vitin 602 (e.j), ata emëruan në vend të tij një mbret persian. Ai vazhdoi të sundonte në Irak, derisa persianët u mundën nga muslimanët, në Betejën e Kadisijes, nën komandën e Saad ibn Ebi Vekas, në vitin 637 (14 të hixhretit).^[2]

BETEJA E KADISIJES

Kjo betejë hapi dyert e Irakut, Horasanit dhe të Turkestanit ndaj muslimanëve, gjatë ditëve të arta të Islamit. Ajo u zhvillua gjatë kohës kur Halife i muslimanëve ishte Omer Ibn El-Hattab.

Gjatë kësaj periudhe, zgjerimet islame po përparonin nga të gjitha frontet. Profecia e të Dërguarit të Allahut, se feja islame do mbizotëronte, po bëhej realitet. Luftëtarët muslimanë ishin të suksesshëm kudo që shkonin.

Disa vite më parë, i Dërguari i Allahut, Muhamedi, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, i kishte dërguar perandorit të Persisë një letër ku e ftonte për të pranuar fenë e Allahut, Islamit, por perandori persian e kishte grisur letrën. Për këtë, i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, kishte thënë: “Kisra nuk grisi letrën time, por ka grisur mretërinë e tij.”

Profeti (a. s) gjithashtu i kishte thënë Udej ibn Hatimit: “Nëse do të jetosh gjatë, do të shikosh tek i merrni thesaret e Kisras (perandorit Persian).”

Persianët ishin të ndërgjegjshëm për forcimin në rritje të forcave muslimane, prandaj ata po përgatiteshin për luftë që ta shpartallonin ushtrinë muslimane.

Kisra u kishte thënë gjeneralëve të tij: “Juve nuk ju mungojnë armatimi, pasuria as fuqia, prandaj ngrihuni dhe thërrmijini muslimanët!”

Omer Ibn El-Hattab, prijësi i besimtarëve, e kishte marrë vesh lajmin për përgatitjen e persëve, prandaj edhe ai kishte filluar përgatitjet. Ai kishte urdhëruar një komandant të aftë, Muthenne Ibn Harithe, të shkonte nëpër fiset rreth e rrotull, dhe të rekrutonte këdo që ishte i aftë për luftë.

Ndërkohë edhe persianët po bënin përgatitjet e veta.

Në këtë betejë kaq të rëndësishme, Omeri deshi ta drejtonte vetë ushtrinë, por pas konsultimit me shokët e tij, ata i sugjeruan që të mos shkonte në luftë, por të dërgonte njëburrë të fortë e të besueshëm, dhe caktuan Sead ibn Ebi Vekkasin, sahabin e përgëzuar me xhenet, nga vetë i Dërguari i Allahut.^[3] Saadi arriti të mblidhte një ushtri prej tridhjetë mijë luftëtarësh.

Nga ana e persianëve, Jezdexhridi i 3-të, e urdhëroi gjeneral Rustem Farrohzadin ta drejtonte ushtrinë e tyre, e cila arriti një numër prej rreth tetëdhjetë mijë ushtarësh, dhe që kishin edhe një numër të madh të elefantëve që i përdornin për luftë.

Nga korriku i vitit 636, muslimanët ngritën kampin e tyre ushtarak në Kadisije. Omeri (r. a) e urdhëroi Saadin që të dërgonte emisarë tek Jezdexhridi i 3-të, dhe tek gjenerali i ushtrisë Sasanide, Rustam Farrohzad, për t’i ftuar ata që të hynin në Islam, ose të pranonin të paguanin xhizjen. Delegacionin musliman e udhëhoqte En-Numan ibn Mukarrin, të cilët shkuan në Ktesifon, dhe u takuan me perandorinsasanid, Jezdexhridi i 3-të, por misioni dështoi.

Negociatat midis arabëve dhe persëve vazhduan për tre muaj rresht.

Gjatë një takimi mes tyre, Jezdexhridi i 3-të, kishte dashur të poshtëronte emisarët muslimanë, prandaj i kishte urdhëruar shërbëtorët e tij, që t’i hidhnin një kovë të mbushur plot me dhë mbi kokë Asim ibn Amr-it, njërit nga anëtarët e delegacionit. Asim ibn Amr, përkundrazi, e kishte interpretuar këtë gjest me fjalët e mëposhtme: “Urime! Armiku na i dorëzoi vullnetarisht territoret e tij” (Duke iu referuar dheut në kovë).^[4]

Rustemi, gjenerali persian, kishte pasur të njëjtinkëndvështrimme Asim ibn Amr-in. Thuhet se ai e qortoi Jezdexhridin e 3-të për këtë veprim që bëri, sepse ky akt nënkuptonte se persianët ia dorëzuan vullnetarisht vendin e tyre muslimanëve. Jezdexhridi i 3-të, pasi kishte dëgjuar këto fjalë nga gjeneral Rustemi, i kishte urdhëruar ushtarët t’i ndiqnin dhe t’i gjenin emisarët muslimanë, dhe ta rimerrnin kovën, por ata tashmë kishin mbërritur në kampin e tyre.

Pas tre muajsh negociatash pa rezultat, Omeri, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, kishte urdhëruar që të mos vazhdohej më. Ky urdhër i tij, ishte një sinjal i hapur për persët që të përgatiteshin për betejë.

Rustemi u përpoq t’i joshte me pasuri muslimanët që të ktheheshin, në përpjekje për t’i përmirësuar marrëdhëniet me ta, e duke patur ndër mend të kaluarën e tyre superiore mbi arabët, por përgjigjja e muslimanëve ishte gjithmonë e njëjta: Të zgjidhnin ose Islamit, ose haraçin-xhizjen, ose luftën.

Kur u panë se nuk kishte rrugë tjetër, përveç luftës, ata i dërguan fjalë Seadit, duke i thënë: Ose kaloni ju tek ne, ose të kalojmë ne tek ju (mes tyre ndodhej lumi). Seadiu kishte thënë: Ejani ju tek ne!

Pastaj ata i kishin kërkuar të largoheshin nga ura, që të kalonin, por ai nuk kishte pranuar, kështu që ata u detyruan të gjenin një kalim tjetër dhe zunë vend në breg të Atikës, një degë e lumit Eufrat.

Jezdexhridi kishte shpikur një metodë të re të lajmërimit, pasi kishte vënë një varg burrash, të cilët qëndronin në një distancë të caktuar larg njëri-tjetrit, dhe që e përcillnin me gojë çdo lajm dhe çdo lëvizje të dy ushtrive që po luftonin, deri tek ai.

DITA E PARË E LUFTIMEVE: DITA E ÇRRREGULLIMIT

Seadi po e drejtonte luftën nga pozicioni i tij, ndërsa përpara kishte ushtrinë muslimane me prijësit e saj.

Fillimisht, beteja nisi me rrëmbimin e një numri ushtarësh persianë dhe me vrasjen e tyre. Pastaj Seadi dha urdhër dhe lufta e ashpër mes dy ushtrive, filloi. Ushtria perse kishte me vete elefantë, ku gjashtëmbëdhjetë të tillë i drejtuan drejt fisit musliman Bexhile, duke ua trembur kuajt dhe gati sa nuk i shkatëruan të gjithë sa ishin.

Komandant Asim ibn Amir urdhëroi ushtarët e tij që t'i zbrapsnin elefantët, t'i këpusnin litarët me të cilët ishin lidhur arkat që mbanin ushtarët sipër, pastaj t'i hidhnin poshtë gjithëkush ishte sipër tyre, dhe ashtu bënë. Elefantët u rrëzuan, dhe bashkë me ta gjithë ushtarët që qëndronin majë tyre, të cilët i vranë. Lufta vazhdoi derisa erdhi nata, pastaj njerëzit u mbledhën në kampet e tyre. Atë ditë pati mjaft të vrarë nga të dyja palët.

Dita e parë e betejës së Kadisijes njihet si Jeum el-ermaath ("يومأرمات") ose "Dita e çrregullimit"

DITA E DYTË: DITA E NDIHMËS

Atë ditë për muslimanët, mbërritën forca ndihmëse nga Shami (Levanti). Ata ushtarë muslimanë që erdhën, ishin ata që kishin qenë me Halid ibn El-Velidin në tokat e Sirisë, dhe që u kthyen sipas urdhërit të Omer Ibn El-Hatabit. Mes tyre ishin komandantët El-Ka'kaa Ibn Amru dhe Hashim Ibn Utbe, të cilët kishin me vete gjashtë mijë luftëtarë. Ata kishin mbërritur në Kadisije në mëngjesin e ditës së dytë. Sapo kishte mbërritur komandant El-Ka'kaa, kishte bërë thirrje për një duel, të cilit i ishte përgjigjur Bahmani, komandanti persian dhe një komandant tjetër. El-Ka'kaa kishte dalë bashkë me Harith Ibn Dhabjan, dhe i kishin vrarë dy komandantët persianë. Kjo fitore e ngriti lartë moralin e ushtrisë muslimane, të cilët luftuan fort edhe ditën e dytë.

DITA E TRETË: DITA E LUFTËS INTENSIVE

Këtë ditë, persianët kishin përgatitur përsëri elefantët, me të cilët i befasuan sërish muslimanët. El-Ka'kaa ibn Amr dhe Asimi, dolën bashkë me grupin e tyre dhe mësynë elefantin e bardhë që ishte elefanti më i madh, dhe ia shpuan syrin me shigjeta. Pastaj ia prenë edhe noçkën. Një grup tjetër muslimanësh, mësynë një tjetër elefant të madh të ushtrisë perse, dhe bënë si me elefantin e bardhë.

Dy elefantët e mëdhej iu kthyen ushtrisë perse, duke marrë nga pas edhe

elefantët e tjerë, të cilët ia mbathën nga fushbeteja, bashkë me gjithë ushtarët që mbanin sipër. Luftimet vazhduan intensive për gjatë gjithë ditës, e deri natën. Ajo natë u quajt "Nata e zhurmave gjëmuese". Asgjë nuk dëgjohej, përveç tringëllimave të shpatave. Kontaktet e komandantëve me ushtarët e tyre u shkëputën. As Seadi nuk e dinte se çfarë po ndodhte me muslimanët, as Rusteminuk e dinte se çfarë kishte ndodhur me persianët. Në mëngjes, njerëzit u ndalën, dhe fitorja ishte për muslimanët.



DITA E KATËRT: DITA E KADISIJES

Mëngjesin e "Natës së zhurmave gjëmuese", kur luftimet kishin vazhduar deri në mëngjes, El-Ka'kaa kishte thënë: "Duron, sepse po të duroni këtë kohë, fitorja do të jetë juaja, me lejen e Allahut."

Muslimanët u përzien me persët, dhe luftuan kundër tyre. Kur erdhi dreka, muslimanët arritën të depërtojnë në zemër të ushtrisë perse.

El-Ka'kaa bashkë me luftëtarët që kishte me vete, mbërritën tek Rustemi, por ai u fsheh shpejt mes mushkave të ngarkuara me mall. Atje i shkoi Hilal Ibn Ulkeme, i cili e preu litarin që mbante lidhur ngarkesën mbi mushkë, dhe ngarkesa ra mbi Rustemin që po qëndronte i fshehur, duke ia thyer kurrizin. Ashtu i plagosur, Rustemi vrapoi drejt lumit, por e ndoqi Hilali dhe e tërhoqi nga këmba, e nxorri në breg dhe e vrau. Pastaj thirri: E vrava Rustemin, për Zotin e Qabes!

Në këtë betejë, nga muslimanët ranë dëshmorë rreth tetë mijë e pesëqind luftëtarë, ndërsa nga persët u vranë më shumë se pesëdhjetë mijë. Ushtria persiane u shpartallua, dhe vetëm pak prej tyre mbërritën në qytete.^[5]

PASOJATE BETEJËS

Sapo mbaroi beteja e Kadisijes, Seadi i dërgoi Omerit një raport të fitores së muslimanëve. Beteja e tronditi sundimin sasanid në Irak, në themelet e tij, por ky nuk do të ishte fundi i sundimit të tyre në Irak. Për aq kohë sasasanidët mbanin Ktesifon-in si kryeqytetin e tyre, ekzistonte gjithmonë rreziku që në një

moment të përshtatshëm, ata do të bënin një përpjekje për të rimarrë atë që kishin humbur, dhe t'i largonin muslimanët nga Iraku. Prandaj, Kalifi Omer, i dërgoi udhëzime Seadit se si vazhdimin e Betejës së Kadisijes, muslimanët duhet ta shtynin përpara, për të marrë Ktesifon-in. Rrethimi i Ktesifon-it kishte vazhduar për dy muaj, dhe qyteti më në fund, u mor në mars të vitit 637. Forcat mysliane pushtuan krahinat persiane deri në Khuzistan. Megjithatë, zgjerimet islame u ngadalësuan nga një thatësi e madhe në Arabi në vitin 638, si dhe nga një epidemi që ra në Irakun jugor dhe në Siri, në vitin 639. Pas kësaj, Omeri mendonte se ishte i nevojshëm një pushim, dhe për atë kohë, ai dëshironte ta linte pjesën tjetër të Persisë për persianët. Omeri, transmetohet se ka thënë: "Uroj që të ketë një mal zjarri mes nesh dhe persëve, kështu që as ata të mos mund të na vijnë, dhe as ne tek ata".

Perspektiva persiane, megjithatë, ishte e kundërta polare e një sikleti të madh, poshtërimi dhe talljeje. Krenaria e sasanidëve perandorakë ishte lënduar nga pushtimi i Irakut nga muslimanët, dhe ata vazhduan luftën për të rifituar territorin e humbur. Kështu, një kundërsulm i madh persian nisi, dhe më pas u zbraps, në Betejën e Nahavand-it, që u zhvillua në dhjetor të vitit 641.

Pas kësaj, një nënshtrim i plotë i perandorisë Persiane sasanide, ishte planifikuar nga Omeri (r. a), për ta mposhtur plotësisht rivalin e tij armik. Perandori i fundit persian, Jezdexhridi i 3-të, u vra në vitin 653, gjatë kohës kur Kalifi i muslimanëve ishte Othmani (r. a). Vdekja e tij shënoi zyrtarisht fundin e linjës mbretërore dhe perandorake Sasanide.^[6]

Vazhdon...

Përgatiti:

Msc. **Arta Ujkaj**, teologe

1. <https://www.cia.gov/library/publications/resources/the-world-factbook/geos/iz.html>
2. <https://www.aljazeera.net>
3. THE FALL OF THE MIGHTY PERSIAN EMPIRE, Abdul Malik Mujahid
4. Tariih Et Taberij
5. <https://www.alukah.net/culture/0/116859/>
6. https://en.wikipedia.org/wiki/Battle_of_al-Q%C4%81disiyyah#cite_note-24

NËNË GJATË DITËS, STUDIUESE GJATË NATËS: NJIHUNI ME FATIMAN, SHKENCËTAREN QË KUPTON GJUHËN E BAKTEREVE

Ndërsa shumë kolegë të saj shijojnë mbrëmjen duke ndjekur Netflix, biologja dhe nanofizikantja molekulare analizon rezultatet e hulumtimit. Pasi i rehaton fëmijët në gjumë, ajo i bën vetes një filxhan të shijshëm kafeje dhe nis hulumtimet mbi jetesën e baktereve trupore...



Duke ndjekur studimet e doktoratës në Universitetin Teknik të Danimarkës, shkencëtarja e nanofizikës, Fatima AlZahra'a Alatraktchi zhvilloi një sensor që mund të zbulojë infeksionet bakteriale para se ato të shkatërrojnë sistemin imunitar.

Kjo u ndihmon personave që kanë probleme të lindura me imunitetin, të cilët tërë jetën e tyre janë në luftë me bakteret, luftë e cila shpeshherë përfundon në moshën e tyre shumë të re.

Duke qenë e përkushtuar për zbulimin e një pajisjeje më efikase se ato tradicionalet që gjenden në laborator, ajo shpiku mjetin tashmë të patentuar, PreDiagnose.

Revista Forbes e radhiti Fatiman, 29-vjeçare, në listën e personave më të suksesshëm të vitit 2018, në sajë të zbulimit më të madh sa i përket fushës së imunologjisë dhe rezistencës së baktereve.

Zbulimi i saj përshkruhet si një "mjet i cili dekodon komunikimin e baktereve" dhe përcakton me saktësi rezistencën e

antibiotikëve.

Testi i cili së shpejti do të bëhet në klinikat në Danimarkë, diagnostifikon probleme nga infeksionet e mushkërive e deri te kanceret.

Mjeti që ajo ka zhvilluar në sajë të kërkimeve disavjeçare, faktikisht i përkthen "kodet" që bakteret ia dërgojnë njëra-tjetres dhe kupton kur ato janë kërcënuese për jetën.

Zakonisht, pacientët drejtohen për analiza kur shfaqin probleme shëndetësore, por mos të harrojmë, ka shumë prej tyre, e veçanërisht fëmijët që lindin me sëmundje të imunitetit, ku organizmi është i paaftë të luftojë me bakteret.

Në këto raste, doktorët përshkruajnë antibiotikë "paushall" në përpjekje për të ndaluar infeksionet të cilat te këta pacientë janë vdekjeprurëse.

Sipas shkencëtares Fatima, mjeti që ajo ka zhvilluar e dekodon gjuhën e baktereve dhe e zbulon brenda pak sekondash nëse bakteret janë duke u përgatitur për ofensivë të ashpër apo jo.

Sipas saj, doktorët më nuk do të duhet të veprojnë në bazë të prognozave, por do të kenë para duarsh rezultatet e gjendjes aktuale të baktereve brenda organizmit.

Një tjetër rrezik që po e trajton shkëlqyeshëm zonja Fatima është lufta kundër rezistencës së antibiotikëve, e cila është alarmante në shumë pjesë të botës.

Kjo bën që një numër i madh i infeksioneve jo më vdekjeprurëse, si pneumonia, tuberkulozi, gonorreja dhe salmonelloza, të trajtohen më me vështirësi.

Përcaktimi i saktë i dozës dhe metodës së trajtimit të cilësdo sëmundje që kërkon antibiotik, tani e ka përballë mjetin që nga qarqet mjekësore po quhet me emrin "Revolucion".

Fatima AlZahra'a Alatraktchi është 29 vjeçe dhe jeton në Greve të Danimarkës, me burrin (gjithashtu shkencëtar) dhe dy vajzat e saj.

(www.tesheshi.com)



PALESTINA

Dikur mediat draportonin për 'luftën në territoret e okupuara palestineze'! Sot ato informojnë për 'konfliktin izraelito-palestinez'! Pra ato e barazuan okupatorin dhe atë që e mbron atdheun e vet! Dikur mediat thoshin: forcat pushtuese izraelite vranë palestinez të pafajshëm!

Sot ato thonë: pati viktima në përleshjet mes protestuesve palestinez dhe policisë izraelite! Pra, u barazua krimi shtetëror dhe viktima! Po pra, sot edhe fjalori mediatik është vënë në shërbim të krimit dhe ka për qëllim të na bëjë të pandjeshëm ndaj vuajtjes së të tjerëve si dhe, të mos mund ta dallojmë viktimen nga vrasësi!

Ne pra jetojmë në kohë kur 'fjalori' informativ e përcakton të vërtetën dhe e mbulon realitetin e hidhur! Por për fat të keq tonin, nuk ekziston mbulesë për t'i fshehur 'vrasësit' më të rrezikshëm të sotëm: ata që e shpikin dhe kontrollojnë 'fjalorin' e verbërisë dhe shurdhërisë mbarënjerezore, e ku bëjmë pjesë edhe ne që heshtim dhe e besojmë atë!"

(www.facebook.com/
KimMehmeti)

“MËSOJMË DHE ARGËTOHEMI” ME FËMIJËT E XHAMISË SË OBLIKËS, URA E BUNËS DHE FALTORES “ILIRIA”, SHTOJ I RI.

Ditën e martë, më 02 korrik 2019, sektori i arsimit pranë Myftinisë Shkodër organizoi aktivitetin e radhës të projektit “Mësojmë dhe argëtohem” me nxënësit e kurseve fetare të xhamive Ura e Bunës, Oblikë dhe faltores “Iliria”.

Aktiviteti u zhvillua në xhaminë e Plumbit dhe u hap nga përgjegjësi i arsimit, teologu Arben Halluni, i cili i njohu nxënësit me projektin mësimor dhe argëtues.

Në këtë veprimtari mori

pjesë Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili u mbajti një këshillë fetare nxënësve të pranishëm rreth rëndësisë që ka mësim-besimi islam tek brezat e ri si dhe për historikun e xhamisë së Plumbit.

Myftiu Sytari falënderoi imamët e xhamive përkatëse, Taksim Plori, Nadi Braçi dhe Agim Elezi, të cilët punojnë me përkushtim dhe pasion me nxënësit e tyre, duke iu përcjellë traditën e bukur islame të vendit tonë, frymën e harmonisë dhe



dashurisë në mes njerëzve.

Projekti “Mësojmë dhe argëtohem” u shoqërua edhe me konkurse fetare, lojëra të ndryshme sportive dhe argëtuese.

NIS CIKLI 10 JAVOR I HYTBEVE NË XHAMINË E LUARZIT, VELIPOJË

Ditën e xhuma, më 5 korrik 2019, nisi cikli 10 javor i hytbeve të larmishme në xhaminë e Luarzit, Velipojë.

Për të tretin vit radhazi, Myftinia Shkodër ka hartuar një program, ku janë përfshirë një pjesë e mirë e teologëve aktivë, të cilët do të mbajnë hytben e xhumasë në xhaminë e Luarzit.

Ky projekt vjen edhe në përgjigje të interesit të pushuesve të shumtë në plazhin e Velipojës të cilët vuajnë prej kohësh mungesën e një xhamie në vendin fshatin turistik.

Përtej angazhimit të Myftinisë Shkodër për ndërtimin e një xhamie në Velipojë,

e xhumaja falet rregullisht në xhaminë e fshatit Luarzë, në zonën e Velipojës. Kjo ia lehtëson pushuesve muslimanë faljen me xhemat dhe prezantimin e hytbes së javës.

Cikli i ri 10 javor, nisi me hytben e Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, sikurse do të vijojë, sipas programit të lajmëruar më parë dhe të afishuar edhe në xhaminë e Luarzit.

Vlen të falënderohet përkushtimi i madh i imamit të xhamisë Luarzë, z. Hajrullah Jakupi dhe ai i këshillit të xhamisë, për përkujdesjen dhe mikpritjen e frekuentuesve të shumtë të kësaj xhamie.

PROGRAMI 10 JAVOR I HYTBEVE NË XHAMINË E LUARZIT, VELIPOJË	
PROGRAMI:	
1- 5 korrik 2019, Imam Muhamed Sytari:	“Hytërimi në xhami të Javës”
2- 12 korrik 2019, analozi Ervil Kushi:	“E mirë në jetën e muslimanit”
3- 19 korrik 2019, analozi Arben Halluni:	“Kisha në jetën e muslimanit”
4- 26 korrik 2019, analozi Durim Kasami:	“Dhuni, dhunti e dhuntimit”
5- 2 gusht 2019, analozi Adem Pira:	“Zakaria, thirrja e brendshme e zemrës”
6- 9 gusht 2019, analozi Rashid Plumbi:	“Dita e drejtësisë, me e bëjmë ditë”
7- 16 gusht 2019, analozi Gilman Kasami:	“Thirrja e Allahut në Kur'anin Fashih”
8- 23 gusht 2019, analozi Idnis Plaku:	“Mishkimi e All-llahut ka përfundim jo qe”
9- 30 gusht 2019, analozi Adnan Ueq:	“Si të kuptojmë Hytërit e Reshollit Allahut (a.s.)”
10- 6 shtator 2019, analozi Adil Cakali:	“Mësojmë në mënyrën dhe fjalën e All-llahut”

MYFTIU PRITI DREJTORIN E QENDRËS KULTURORE “YUNUS EMRE”, SHKODËR

Paraditën e së hënës, më 8 korrik 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, z. Zafer Kiyıcı, drejtor i Qendrës Kulturore “Yunus Emre”, Shkodër.

Gjatë takimit u diskutua mbi çështje me interes të përbashkët, sidomos në ato që lidhen me trashëgiminë kulturore dhe shpirtërore, ku është e mundur edhe bashkëpunimi në mesin e dy institucioneve.



MYFTIU, IMAMËVE: “TË MOS BIEM NË BATAKUN E PROVOKIMEVE PRIMITIVE ISLAMOFOBE!”

Paraditën e së hënës, më 8 korrik 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me një grup imamësh të qytetit e fshatit.

Në qendër të vëmendjes ishte situata aktuale, nëpër të cilën kalon vendi dhe përpjekja e qarqeve të caktuar për të mbuluar krahurën ku është zhytur vendi, me provokime banale me bosht islam, si çytjet e disave për të provokuar debate shterpë rreth ezanit, hixhabit, çështjeve të ndryshme islame, etj.

Myftiu kërkoi nga imamët të mos bien në nivelin e ulët të këtyre provokimeve islamofobe, që duan të largojnë vëmendjen e masës nga realiteti ku gjendet vendi, mjerisht.

Myftiu lajmëroi edhe për incidentin e radhës me zaptuesin e vakëfit në Zogaj. Ai shprehu vullnetin e tij për ta çuar deri në fund rrethimin e vakëfit dhe këputjen e tentakulave të së keqes që pengojnë zhvillimin e tij në Zogaj dhe përtej saj!

Më pas, u diskutua edhe për disa



çështje që lidhen me aktivitetin e brendshëm të xhamive dhe Myftinisë Shkodër, inaugurimin e xhamisë në lagjen Draçin, vazhdimin e punimeve për xhamitë e reja në Kiras e Shirq,

angazhimin për projektin e xhamisë së re në Rus, interesimin për gjetjen e një hapësire për xhaminë e munguar në Dobraq, si dhe shfrytëzimin e disa vakëfeve në Shkodër.

ZHVILLOHET SEMINARI TRAJNUES MBI JETËN E HZ. MUHAMMEDIT (A.S.)



në të njëjtin universitet, për Kur'an dhe Traditë Profetike. Është autor dhe bashkautor i disa librave në fushën e Kur'anit Famëlartë dhe Traditës Profetike.

Është organizator i një kursi shkencor për Biografinë e Profetit (a.s), kurator i disa ekspozitave, trajnues i ekipeve që ofrojnë ekspozita të biografisë së Profetit (a.s) në Francë, Gjermani, Zvicër, Emirate të Bashkuara Arabe, Turqi, Kanada, Bahrein, Arabia Saudite, Belgjikë, Katar, Marok, Algjeri, Suedi, Itali, Holandë, Norvegji, Bosnje, Islandë, Rumani, Danimarkë etj. Gjithashtu është autor i disa kërkimeve shkencore në fushën e studimeve të Kur'anit dhe Traditës Profetike.

Paraditën e së mërkurës, më 10 korrik 2019, Myftinia Shkodër organizoi seminarin e specializuar trajnues për imamët, teologët dhe thirrësit islamë arabishtfolës, me temë: “Biografia e të Dërguarit të All-llahut (a.s.) përmes përdorimit të metodave të larmishme”, me ligjërues personalitetin e shquar të kësaj lëmie, Dr. Ammar M. Munla, nga Medina e Arabisë Saudite.

Kush është Dr. Ammar M. Munla:

Ka mbaruar studimet e larta për Bazat e Fesë (Usulud-Din) në universitetin Umul-Kura, Mekë, Arabia Saudite. Nivelin Master dhe Doktoraturën e ka mbrojtur



MINAREJA E MILANIT, DRITË UDHËZIMI PËR ZONËN

Ditën e enjte, më 11 korrik 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një inspektim në terren për të parë arritjet e punimeve që po kryhen për realizimin e minaresë së munguar të xhamisë në lagjen Milan-Rrasek, Domën.



NË RAHMET TË ALL-LLAHUT, PLAKU I URTË, H. SELIM SYKAJ

Ditën e xhuma, më 12 korrik 2019, ndërroi jetë aktivisti i zellshëm i Myftinisë Shkodër, imami dhe edukatori i mirënjohur i zonës Ura e Shtrenjtë, H. Selim Sykaj.

Për shumë vite, ai u përkushtua në shërbim të xhamisë dhe besimtarëve, sidomos brezit të ri, me qëllim mësimin dhe edukimin me mësimet dhe udhëzimin e Kur'anit Famëllartë dhe Traditave të Hz. Muhammedit (a.s.).

Për 25 vite, ai kreu me shumë përkushtim detyrën e imamit, muezinit, hatibit dhe edukatorit fetar për dhjetëra fëmijë frekuentues të rregullt të kurseve fetare të xhamisë së Urës së Shtrenjtë, deri kur u tërhoq nga shërbimet e rregullta dhe detyra, për shkak të gjendjes jo të qëndrueshme shëndetësore.

Më herët, në vitin 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, teksa shprehte vlerësimet dhe mirënjohjen e tij personale dhe të Myftinisë Shkodër për të nderuarin, H. Selim Sykja, do t'i dorëzonte imamit të përkushtuar, Certifikatën e Mirënjohjes së Myftinisë Shkodër, duke theksuar falënderimet dhe përlujtjen për shembullin e njerëzve të përkushtuar për fenë islame, në veçanti



të H. Selim Sykja, që u dëshmtua përherë i gatshëm për të shërbyer, ku ishte e nevojshme, plot fisnikëri dhe dashuri për Thirrjen Islame dhe njerëzit, pa dallim!

Myftinia Shkodër ju fton në namazin e xhenazes së zotërisë së tij, H. Selim Sykaj, ditën e shtunë, më 13 korrik 2019, ora: 11.00, te xhamia e fshatit Ura e Shtrenjtë!

All-llahu e mëshiroftë dhe e lartësoftë gradën e rahmetliut, H. Selim Sykaj, në xhennetet e Tij! Amin!

TË XHUMANË E ARDHSHE HAP DYERT XHAMIA E RE NË DRAÇIN

Ditën e xhuma, më 12 korrik 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, inspektoi nga afër xhaminë e re të lagjes Draçin, frut i bashkëpunimit të Myftinisë Shkodër dhe Fondacionit "Mirësia".

Xhamia e re e lagjes Draçin, e ndërtuar mbi të njëjtin vakëf, ku ndodhej edhe më parë, pritet të përurohet ditën e xhuma, më 19 korrik 2019, duke sjellë një gëzim të shumëpritur për muslimanët e zonës.

Gjatë inspektimit të kësaj dite, Myftiu shprehu kënaqësinë e tij për arritjen e realizimit të këtij projekti, që pajis edhe lagjen muslimane të Draçinit me xhaminë e saj, në kuadër të qëllimit të madh të pajisjes së çdo lagjeje muslimane me xhaminë e vet.



IMAMI I XHAMISË "EYÜP SULTAN" TË STAMBOLLIT LIGJËRON NË XHAMINË E PARRUCËS



Ditën e hënë, më 15 korrik 2019, besimtarët muslimanë shkodranë, frekuentues të xhamisë së Parrucës, por jo vetëm, patën mundësi të dëgjonin nga afër këndimet e mrekullueshme dhe ligjërimin e imamit mirënjohur të xhamisë së sahabiut Ebu Ejub El-Ensari (r.a.) në Stamboll të Turqisë, Hafiz Metin Çakar.

Vizita e imamit të mirënjohur turk në qytetin e Shkodrës, vjen si pjesë e programit përkujtimor: "15 Korrik – Dita e Demokracisë dhe Bashkimit Kombëtar", që organizohet nën kujdesin e Presidencës së Republikës së Turqisë dhe Ambasadës së Republikës së Turqisë në Tiranë.

I pranishëm në këtë aktivitet ishte edhe Ambasadori i Republikës së Turqisë në Tiranë, Sh.T.Z. Murat Ahmet Yörük, Drejtori i Qendrës Kulturore "Yunus Emre" në Shkodër, z. Zafer Kayıcı, korrespondenti i luftës së Agjencisë Anadolu, z. Samet Doğan si dhe veterani i 15 korrikut, z. Sabri Gündüz.

Në fjalën e rastit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, falënderoi ambasadorin turk për praninë e tij në

Shkodër, duke theksuar se miqësia dhe vëllazëria shekullore në mesin e dy popujve tanë mbetet një garanci e patundur e vazhdimësisë në rrugën e bashkëpunimeve dhe angazhimeve të përbashkëta në shërbim të vëllazërisë së sinqertë shekullore.

Myftiu falënderoi imamin e nderuar nga Stambolli, sikurse theksoi se vizita e tij është një moment gëzimi për

besimtarët muslimanë në Shkodër.

Hafiz Metin Çakar, pas këndimit të musalasë dhe disa pjesëve kur'anore, iu drejtua të pranishmëve me një ligjëratë plot njohuri dhe të dhëna mbi sahabiun Ebu Ejub El-Ensari (r.a.), sakrificën në rrugën e All-llahut (xh.sh.), çlirimin e Kostandinopojës dhe u lut për mbarësi dhe bekime për të pranishmit dhe krejt popujt e botës.

MYFTIU PRITI PËRFAQËSUESIN E LARTË TË "BEJTUZ-ZEKAT" NGA KUVAJTI



cilësisë së aktivitetit të Myftinisë Shkodër, shërbimeve të saj në komunitet dhe Thirrjes Islame në përgjithësi.

Myftiu shprehu falënderimet e përsëritura për Shtetin e Kuvajtit, institucionet e tij bamirëse dhe të gjithë bamirësit e ndryshëm, për kontributet e larmishme dhe të shumta në vendin tonë, që dëshmojnë më së miri qëllimet fisnike të bamirësve kuvajtianë dhe vullnetin e solidaritetit në mesin e besimtarëve.

Ditën e martë, më 16 korrik 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt z. Adil El-Xheri, Drejtor i Zyrës për Veprimtarinë me Jashtë në "Bejtuz-Zekat", që shoqërohej nga z. Korab Kaja, Drejtor i Fondacionit "Mirësia" në Tiranë.

Gjatë takimit u diskutuan për rrugët dhe mundësitë e ndryshme të bashkëpunimit të përbashkët, duke u fokusuar në projekte konkrete, që i shërbejnë mbi të gjitha rritjes dhe



NISIN PËRGATITJET PËR PËRCJELLJEN E HAXHILERËVE SHKODRANË

Tashmë e kthyer në traditë, trajnimi dhe përcjellja e haxhilerëve të Shkodrës, sa vjen dhe përmirësohet dhe merr formë përherë e më tërheqëse, me qëllimin e vetëm të shërbimit ndaj miqve dhe të ftuarve të All-lahut të Madhëruar, bazuar në fjalën e madhe të Hz. Muhamedit (a.s.), që thotë: “Haxhilerët dhe umrexhitë janë të ftuarit e All-lahut...”.

Nga kjo dëshmi, Myftinia Shkodër është e angazhuar që të ofrojë sa më shumë shërbime që i paraprijnë udhëtimit

të begatë të haxhilerëve tanë të nderuar.

Këtë vit, programi do të shtrihet në periudhën 22-27 korrik 2019, gjatë së cilës, të regjistruarit për Haxhin e sivjetshëm, do të kenë mundësi të përfshihen në përshpirtjen e prag-udhëtimit të shumëpritur prej tyre.

Gjatë javës së ardhshme, do të lajmërohet edhe dita dhe ora e caktuar për përcjelljen e haxhilerëve të këtij viti.

Lutemi që All-lahu i Madhëruar t'i japë mbarësi e sukses haxhilerëve, si dhe të na mbulojë me mëshirë e bekim!



PROGRAMI I TRAJNIMIT TË HAXHILERËVE SHKODRANË TË VITIT 1440/2019

E HËNE 23/7/2019	9:00 - "Haxhi Vehbi Dibrë, haxhilerëve të vitit 1934", nga Imam Muhamed B. Sytari Pushim për kufje e çif 10:00 - "Si të kryejmë Haxhin?" (1) - Teologu Ruzhdi Plangaj
E MARTË 23/7/2019	9:00 - Këshilla dhe udhëzime për haxhilerët - Teologu Edmir Plaku Pushim për kufje e çif 10:00 - "Si të kryejmë Haxhin?" (2) - Teologu Ruzhdi Plangaj
E MËRKURË 24/7/2019	10:00 - Takim i paqendrës për motrat Ligjëratë, pyetje-përgjigje: Teologu Ferret Ndoja
E ENJTE 25/7/2019	9:00 - Udhëzime nga kryetari i grupit të haxhilerëve shqiptarë, H. Lauren Luli Pushim për kufje e çif 10:00 - "Haxhi, bekim dhe mirësi bjornor" - H. Edmir Smajlaj
E XHUMA 26/7/2019	12:30 - Shpërndarja e ibrave për haxhilerët 19:00 - Promovimi i librit: "Lebjeje...!", nga Imam Muhamed B. Sytari
E SHITËNE 27/7/2019	18:30 - Shfaqja e filmit dokumentar: "Rruga për në Mekë"

Ditën e xhuma, më 19 korrik 2019, në një atmosferë vëllazërore, Myftinia Shkodër dhe Fondacioni "Mirësia", zhvilluan ceremoninë e përcjellimit të xhamisë së re të lagjes Draçin.

Në fjalët e tyre përshëndetëse, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj dhe Drejtori i Fondacionit "Mirësia", z. Korab Kaja, shprehën kënaqësinë e madhe të arritjes së realizimit të këtij projekti me dobi, sikurse falënderuan donatorët nga

U PËRURUA XHAMIA E RE NË LAGJEN DRAÇIN



Kuvajti, të cilët dhuruan nga pasuria e tyre gjatë muajit Ramazan, për realizimin e një xhamie, si shenjë përkushtimi ndaj Zotit të botëve.

Në këtë ceremoni merrni pjesë besimtarë të shumtë, drejtues të shoqatave kulturore e bamirëse, drejtori i Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", bashkëpunëtorë të Myftinisë Shkodër dhe miq të shumtë të ardhur edhe nga qytetet e tjera.



"MIRËNJOHJA E QYTETIT" PËR IMAMIN E XHAMISË SË RUSIT, H. FEJZI ZAGANJORI

Pasditën e së xhumasë, më 19 korrik 2019, Myftinia Shkodër dhe Këshilli i Bashkisë Shkodër, organizuan ceremoninë e dhënies së vlerësimit: "Mirënjohja e Qytetit", imamit të xhamisë së lagjes Rus, të nderuarit H. Fejzi Zaganjori.

Ceremoninë e përshëndeti Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, i cili vlerësoi kontributin e H. Fejzi Zaganjorit, si imam, vaiz, pajtimtar, kronikan e veprimtar i zellshëm i pajtimit kombëtar dhe paqes sociale.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, z. Xhemal Bushati, para dorëzimit të Certifikatës "Mirënjohja e Qytetit", vlerësoi kontributet e H. Fejzi Zaganjorit, sidomos në vitin 1997, ku së bashku edhe me drejtues të institucioneve fetare në vend, dha një kontribut të dëshmuar për përhapjen e frymës së pajtimit dhe uljen e armëve.

Me shumë emocion, imami i



nderuar mori vlerësimin e bërë nga Këshilli Bashkiak, sikurse iu drejtua të pranishmëve me falënderime dhe këshilla të dobishme, të përligjura me moshën dhe eksperiencat e tij të shumta.

Ceremoninë e përshëndeti edhe këshilltari z. Maxhid Cungu, si dhe

teologu Arben Halluni.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin familjarë e të afërm të H. Fejzi Zaganjorit, imamë e veprimtarë të Myftinisë Shkodër, deputetë, këshilltarë, intelektualë, drejtues të shoqatave, përfaqësues të komuniteteve fetare, etj.

NISI TRAJNIMI I HAXHILERËVE TË SHKODRËS PËR VITIN 1440



të tij, kuptohet qartë madhështia e fesë dhe natyrshmërisë së marrëdhënies së besimtarit musliman me jetën dhe gjithësinë.

Pas një pushimi të shkurtër, nisi edhe ora e trajnimit teorik, ku teologu Ruzhdi Plangaj, shpjegoi për të pranishmit rregullat kryesore ihramit dhe ndalesat e tij, si dhe mënyrën e kryerjes së Umres, që i paraprin Haxhit.

Trajnimi i haxhilerëve shkodranë vijon edhe gjatë ditëve të kësaj jave, sipas një programi të përgatitur me qëllimin e mirë që të regjistruarit e këtij viti të kenë mundësi të hyjnë në atmosferën e këtij adhurimi të mrekullueshëm.

Sipas programit të lajmëruar nga Myftinia Shkodër, ditën e hënë, më 22 korrik 2019, në xhaminë e Parrucës nisi trajnimi i haxhilerëve shkodranë për vitin 1440 h.

Në ligjëratën e mbajtur nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, u vu theksi te madhështia e adhurimit të Haxhit, si një mundësi për të ndryshuar jetën, në rrugëtimet e besimtarit për të ftuar mëshirën dhe kënaqësinë e All-lahut në jetë.

Myftiu trajtoi edhe këshillën e H. Vehbi Dibrës, drejtuar haxhilerëve të vitit 1934, ku shpjegoi se nëpërmjet fjalëve



KËSHILLA DHE UDHËZIME PËR HAXHILERËT SHKODRANË

Paraditën e së martës, më 23 korrik 2019, në vazhden e trajnimit që Myftinia Shkodër po zhvillon me haxhilerët shkodranë të këtij viti, për grupin e besimtarëve që po përgatiten për udhëtimin e mrekullueshëm të Haxhit, ligjëroi teologu Idmir Plaku, imam i xhamisë “Ebu Bekër”.

Në fjalën e tij, imami i nderuar iu drejtua të pranishmëve që ta shfrytëzojnë kohën maksimalisht, duke iu përkushtuar adhurimit në më të mirin e vendeve të botës, me qëllim përfitimin e mëshirës dhe faljes së premtuar.

Ai theksoi se tavafet, namazet dhe leximi i Kur'anit, krahas bamirësisë, solidaritetit e përhapjes së paqes me këdo e kudo, përgjatë krejt ditëve të këtij udhëtimi të shumëpritur; janë shenjë e përkushtimit ndaj Zotit të gjithësisë.

Trajnimi vijoi edhe me pjesën e dytë të shpjegimeve teorike mbi Haxhin dhe rregullat e tij, ku teologu Ruzhdi



Plangaj dha udhëzimet e duhura për të pranishmit.

Ndërkohë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, bëri disa komente që lidhen me qëndrimin në Mina, Arefat, Muzdelife, gjuajtjen e guralecëve, ditën



e Kurban Bajramit dhe vizitën e Resulull-llahut (a.s.).

Për të pranishmit u shpërnda edhe broshura e lutjeve të Haxhit, si dhe një botim i ri mbi jetën dhe shembullin e Hz. Muhamedit (a.s.).

KËSHILLA TË DOBISHME NË PRAG TË NISJES SË HAXHILERËVE TANË



Paraditën e së enjtes, më 25 korrik 2019, vijoi trajnimi i haxhilerëve shkodranë të vitit 1440, ku në program ishin udhëzimet e kryetarit të grupit të haxhilerëve shqiptarë të organizuar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, z. Lauren Luli, si dhe ligjërata e Myftiut të Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj.

Gjatë bashkëbisedimit me të pranishmit u vu theksi tek rëndësia e

respektimit të frymës në grup, përfitimi nga koha, angazhimi për t'i dhënë hakun e duhur të gjitha ritualeve që lidhen me plotësimin dhe kryerjen me saktësi të Umres dhe Haxhit, bashkëpunimi për të ruajtur frymën e harmonisë dhe të vëllazërisë me krejt pjesëmarrësit në Haxhin e sivjetshëm nga mbarë bota, etj.

U lajmërua data e nisjes dhe detajet e organizimit të përcjelljes së haxhilerëve të Shkodrës dhe Malësisë së Madhe, që

edhe si vitet e tjera, do të nisen së bashku nga xhamia e Parrucës.

Aktivitetin e përshëndeti edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili falënderoi stafin e Myftinisë Shkodër, imamët dhe myftilerët e përfshirë në trajnimin e sivjetshëm, si dhe haxhilerët e pranishëm, për vëmendjen dhe angazhimin e tyre gjatë ditëve këtij trajnimi me dobi.

TAKIM NDËRFETAR ME STUDENTË NGA ITALIA



Në tryezën ndërfetare u diskutua edhe çështja e emigrimit dhe përballjes me këtë fenomen nga pikëpamja e besimit dhe fesë.

Studentët dëgjuan referatet dhe

ndërhyrjet e ndryshme nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, Arqipeshkvi Shkodër-Pult, Mons. Angelo Massfra dhe Famullitari i Kishës Ortodokse në Shkodër, At Nikolla Petani.

Pasditën e së enjtes, më 25 korrik 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, në përgjigje të ftesës së bërë nga Arqipeshkvi i Shkodrës, mons. Angelo Massfra, mori pjesë në një takim ndërfetar me studentë nga Italia dhe vende të tjera të Europës, organizuar në Shëngjin të Lezhës nga Universiteta Cattolica del Sacro Cuore.

Gjatë bashkëbisedimit të ngrohtë me studentët, Myftiu hodhi dritë mbi vlerësimin që i bën feja islame marrëdhënieve të shëndosha të njeriut me vëllanë e tij njeri, përtej besimit.

Ai solli në vëmendje të studentëve ajete dhe ndodhi nga jeta e të Dërguarit të All-llahut, Hz. Muhamedit (a.s.), historisë së shkuar islame dhe realiteteve shqiptare t shekujve të shkuar, deri në ditët e sotme, që kanë të bëjnë me thelbin e temës së bashkëjetesës në mesin e popujve e shoqërive me besime të ndryshme, pa frikë e pa paragjykim.

SHPËRNDARJA E IHrameve DHE PËRSHËNDETJA ME HAXHILERËT E VITIT 1440

Ditën e xhuma, më 26 korrik 2019, Myftinia Shkodër organizoi ceremoninë tradicionale të lajmërimit publik të emrave të haxhilerëve të vitit, si dhe shpërndarjen e ihrameve dhe vizave të haxhit.

Para të pranishmëve, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, uroi haxhilerët dhe të pranishmit, duke theksuar se Shkodra është e bekuar nga All-llahu i Madhëruar, i Cili lejoi që nga kjo tokë, edhe këtë vit, një grup besimtarësh të udhëtojnë drejt vendeve të shenjta për të kryer Haxhin.

Ai vijoi: “Haxhilerë të nderuar, që nga ky moment, ju duhet të ndjeheni të lumtur, sepse Resulull-llahu (a.s.) ju ka bërë një dhuratë të jashtëzakonshme.



Ndoshta nuk e dini, ose ju ka kaluar pa u ndalur me vëmendje para saj.

Ai është lutur për ju: “All-llahumme

fale haxhiun...”! A keni dyshim në pranimin e kësaj lutjeje? Por, ka edhe më shumë. Ai (a.s.) ka vijuar në lutjen e tij drejtuar Krijuesit të gjithësisë: “... dhe këdo, për të cilin haxhiu kërkon falje!”.

Prandaj merreni këtë bekim dhe përhapeni kudo me të afërmit dhe të dashurit tuaj!”.

Në vijim, u lexuan emrat dhe u bë shpërndarja e ihrameve dhe vizave për krejt grupin e 36 të regjistruarve për Haxhin e këtij viti.

Pas faljes së namazit të xhumasë, u bë edhe përshëndetja me haxhilerët, të cilët bëhen gati për udhëtimin e ditës së enjte, më 1 gusht 2019, ora: 8.30, para xhamisë së Parrucës.



“LEBBEJKE..!”, BOTIMI MË I RI NGA MYFTIU I SHKODRËS

Ditën e xhuma, më 26 korrik 2019, Myftinia Shkodër organizoi promovimin e botimit më të ri nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, titulluar: “Lebbejke..!”.

Në ceremoninë e promovimit ishin ftuar imamë, teologë, shkrimtarë e publicistë, intelektualë, drejtues të ndryshëm të shoqatave, familjarë e miq të autorit.

Mbi librin ligjëroi teologu Altin Loshi, njëherazi edhe recensent i këtij botimi të ri. Nëpërmjet një analize të detajuar, ai hodhi dritë mbi përmbajtjen e librit dhe rrugën e zgjedhur nga autori për të përcjellë mesazhet e duhura, që nxjerrin në pah madhësinë e Haxhit si adhurim dhe lidhjen e tij me jetën e besimtarit.

Mbi librin diskutoi edhe shkrimtari Xhahid Bushati, redaktor i këtij botimi të ri. Studiuesi Bushati, ndër të tjera theksoi: “Feja myslimane është fe e virtetit. Për virtetin, a virtetet, kemi më shumë se kurrë nevojë sot, kur realitetet tona kanë ngjyra të turbullta, të trishtuara e shpesh tragjike. Leximi i këtij libri bëhet më imperativ, sepse familja myslimane, fëmijët e moshat radhë-radhë, vlerat e vërteta të jetës së tyre do t'i gjejnë edhe në librin islam”.

Ndërsa autori i librit “Lebbejke..!”, Imam Muhamed B. Sytari, pasi falënderoi të pranishmit për kohën e ndarë për të marrë pjesë në këtë promovim, zbuloi se libri i tij i ri është shkruar gjatë ditëve të Haxhit të vitit të kaluar, ku Myftiu



IMAM MUHAMED SYTARI PROMOVON LIBRIN “LEBBEJKE”



bëri haxhin bedel për shpirt të Hoxhës së nderuar shkodbam, Hafiz Ibrahim Repishti, pas kërkesës së bërë nga i biri, prof. Sami Repishti, me banim në ShBA.

Myftiu theksoi se libri i tij i ri është një përpjekje për ta lexuar Haxhin si një kompleks vlerash dhe mundësishë që e zgjojnë muslimanin nga hutimi e kllapia, “për të mos pranuar skllavërimin përçudnues dhe realitetet pa kible, në të

cilat përpëliten sot, shoqëritë islame”.

Të pranishmit patën rast të vizitonin edhe ekspozitën e titulluar: “Frymë e vendeve të shenjta”, ku ishin ekspozuar 80 fotografi të shkrepura nga autori i librit, gjatë vizitave të ndryshme të Mekës e Medines.

Promovimi i librit “Lebbejke..!” u pasqyrua edhe nga mediat lokale të Shkodrës.

MYFTIU PRITI THEMELUESIN E INSTITUTIT “AN-NOOR” PËR TË VERBËRIT

Paraditën e të shtunës, më 27 korrik 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt e vëllazëror, themeluesin e Medresës “An-Noor” për të verbërit në Afrikën e Jugut, Sheikh Hassan A. K. Murchie.

Gjatë takimit, Myftiu dëgjoi nga vizitori i tij për projektin e kësaj shkolle për mësimin e Kur’anit dhe lëndëve të tjera fetare për fëmijët e verbër, nëpërmjet botimeve me sistemin braille (brejl), të përshtatshëm për këtë kategori personash.

Ai shpjegoi angazhimin e institutit të tij për të përhapur degë të tjera nëpër botë, përfshi edhe vendin tonë.

Nga ana e tij, Myftiu shprehu



gatishmërinë e bashkëpunimit me qëllim ardhjen në ndihmë të njerëzve të sprovuar me humbjen e shikimit, për mësimin e tyre

dhe dhënien e mundësisë për t'u integruar në shoqëri edhe nëpërmjet këtij projekti të vlefshëm.

U SHFAQ FILMI “RRUGA PËR NË MEKË”



haxhilerët e pranishëm për bekimin e madh të përzgjedhjes për kryerjen e këtij adhurimi të mrekullueshëm. Njëkohësisht vlerësoi faktin se në Shkodër, tradita e udhëtimit për kryerjen e rritualeve të Haxhit është kthyer në një pikë referimi pozitive, duke ia shtuar vlerat e madhësinë qytetit tonë.

Paraditën e të shtunës, më 27 korrik 2019, në përmbajtje të trajnimit njëjavor me haxhilerët e këtij viti, Myftinia Shkodër shfaqti në kinema “Millenium” filmin dokumentar me titull: “Rruga për në Mekë”, prodhim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Në fillim, Myftiu i Shkodrës uroi

Të pranishmit patën mundësi të ndiqnin filmin, që është ndërtuar mbi bazën e përshkrimeve dhe përjetimeve të haxhilerëve të shumtë shqiptarë.

Me përfundimin e këtij aktiviteti, u mbyll edhe trajnimi i haxhilerëve tanë, që bëhen gati për udhëtimin e shumëpritur, ditën e enjte, më 1 gusht 2019.

GRUPE TË MËDHA HAXHILERËSH NGA MBARË BOTA DREJTOHEN PËR NË QABE



në vendet e shenjta kanë mbërritur 1.084.762 haxhilerë, nga të gjitha pikat kufitare, ajrore, detare dhe tokësore.

Prej tyre, 1.020.562 nga rrugët ajrore, 53.842 nga rrugët tokësore dhe 10.358 nga rrugët detare.

Dyndja e madhe pritët të ndodhë gjatë fundjavës që vjen, ku haxhilerë të shumtë nga mbarë bota kanë rezervuar drejt Arabisë Saudite për kryerjen e rritualeve të Haxhit të sivjetshëm.

Me mbarësinë e All-llahut, grupi i haxhilerëve të Shkodrës, pritët të nisët për në Xhida, ditën e enjte, më 1 gusht 2019, datë që përkon edhe me mbarimin e muajit Dhul-kade dhe fillimin e muajit Dhul-Hixhe 1440.

MYFTIU TAKOI TELOGËT NË PRAG TË KURBAN BAJRAMIT

Paraditën e të mërkurës, më 31 korrik 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, takoi një grup prej imamëve teologë, me të cilët diskutoi për aktivitetin e Kurban Bajramit të sivjetshëm.

Myftiu theksoi se është me shumë rëndësi që të vlerësojmë këto ditë të çmuara të adhurimit dhe lutjes, për të ftuar njerëzit drejt besimit, si dhe për t'i shërbyer besimtarëve.

U diskutua plani i Myftinisë Shkodër për ceremoninë e ditës së Kurban Bajramit, sikurse u kërkuar angazhimi maksimal për këtë peirudhë, në të cilën vizitorë të shumtë vijnë në Shkodër dhe kanë dëshirë të hyjnë në xhamitë tona, të pyesin e të marrin qetësi e paqe.

Myftiu foli edhe për organizimin e haxhilerëve të Shkodrës për këtë vit dhe uroi mbarësi e suksese për imamët, besimtarët dhe qytetarët e Shkodrës.

NË HAXH PËR NËNËN

Haxhi Lika

Kisha vite që e bluaja në kokë, por mundësitë ishin të pakta. E lusja Zotit pandërprerë të më mundësonte vetëm një dëshirë: të bëja Haxhin për nënën time. Ajo është e pamundur. Ka humbur shumë nga gjallëria e saj e dikurshme, ama është rritur dhe është pasuruar me mirësi.

Kujtoj gatin kur më thirri Haxhi Selimi në zyrë:

- Haxhi, kemi vendosur si kryesi të të çojmë për Haxh.

Nuk e di, e humba si Xhaferi simiten, thonë tironsit, por nuk e dhashë veten.

- Në Haxh, në Mekë...

Më iku gjuha. Nuk fola. Kryetari fliste ndërsa devetë e mia po bëheshin gati për udhëtim.

- Po të çojmë për punë, jo për qejf. - foli prerë Kryetari.

Emocionin e atij udhëtimi nuk e përshkruaj dot as sot, edhe pse kanë kaluar 8 vjet. Disa e quajnë udhëtimin i jetës. Por unë në Haxh kam jetuar dy jetë: timen dhe të nënës sime. E kujtoja nënën time në çdo moment dhe jeta e saj më shfaqej si në film: ditën që më kishte lindur, ditët plot sakrificat të rritjes me vështirësi, ecejaket e ndryshme. Shumë kishte ndryshuar nëna ime, por një gjë nuk ka për të ndryshuar kurrë: meraku i saj. Ai vazhdonte të ishte i njëjti, kam përshtypjen si ditën e parë kur më solli në jetë.

Për Haxhin kanë shkruar shumë, por ai i nënës sime ishte i veçantë. Merrja kënaqësi në çdo hap. Shëtisja nëpër kujtime dhe përpara më dilnin sakrificat e saj, fjalët e saj plot urrejtje, dashuria e saj pa masë. Çfarë mund të bëja për t'i shlyer. Unë u luta, bëra gjithçka dhe pikërisht në atë momentin që mendon se e ke shlyer obligimin tënd ndaj nënës...


Eh ai moment... aty për aty të kujtohet fjala përgjyruese e atij sahabiu të nderuar që i tha Profetit (a.s.): “O Profet, e mbajta nënën time në krahë dhe bashkë me të kërva obligimin e Haxhit. A e kam shlyer sadopak obligimin ndaj saj? “Ti nuk ke bërë asgjë. Ajo që ke bërë nuk mund të krahasohet me netët e saj pa gjumë, duke të qëndruar te koka kur të kaplonte sëmundja apo ndonjë frikë e rastit.”

Shpresa ime u fik, por nuk vdiq. Shpresa e njeriut vdes e fundit. Shpresa e besimtarit nuk vdes kurrë!

Nëna ime e plotësoi detyrën e Haxhit, unë falë mirësisë së saj mora emrin “Haxhiu i Qabes”. Shumë ujëra kanë rrjedhur që nga ajo kohë, por meraku im nuk ka ndryshuar: Çfarë të bëj për të shlyer obligimin tim ndaj nënës, edhe pse ajo nuk ma kërkuar kurrë një gjë të tillë!

“Dashuria e nënës nuk vidhet - thotë biri im - ajo fitohet.”

Unë po përpigë. Zoti më nxjerrte faqebardhë!



Vëllazën të dashtun!

**Feja Islame ka dy baza themelore,
të cilat përmbledhen në këtë frazë:**

**“ME PASË RESPEKT PËR URDHNIN E ZOTIT
E ME PASË DHIMSUNÍ PËR KRIJESËN E ZOTIT.”**

H. Vehbi Dibra (1867 - 1937)



www.myftinia-shkoder.org



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org